



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Përkthim Pedagogjik dhe Gramatikë Korrigjuese

Ngarkesa: 6 kredite; 60 orë; 30 leksione / 30 seminare

Viti / Semestri : Viti II , semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master: *Përkthim teknik – letrar dhe Interpretim*

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithsme lëndore: Ky kurs ka për synim që studentët të: Marrin njohuri bazë për mësimdhënien e gjuhës së huaj. Marrin njohuri bazë për lëndën e *Përkthim Pedagogjik* sipas metodave diakronike dhe sinkronike në zhvillimin e kësaj disipline. Zhvillojnë kapacitetet në zbatimin e këtyre metodave dhe teknikave në klasë dhe përdorimi i tyre në funksion të nevojave dhe gjendjes aktuale të klasës.

Objektivat specifike lëndore: kryesor i lëndës *Gramatikës Korrigjuese* (Italisht-Shqip) është njohja nga ana e studentit e një sërë vështirësish që hasen gjatë nxënies dhe gabimet që hasen rëndom në përdorimin e strukturave gramatikore të gjuhës italiane si gjuhë e huaj nga studentët shqiptarë. Ajo synon, gjithashtu, të ndihmojë studentët të kuptojnë disa nga ndryshimet strukturore mes dy gjuhëve. Kjo lëndë synon, gjithashtu, të hetojë dallimet mes dy gjuhëve, me qëllim që t'u ofrojë të dhëna disiplinave të gjuhësisë së zbatuar, si p.sh. mësimdhënia e gjuhës së huaj dhe studime përkthimore.

Rezultate të pritshme:

Në fund të kursit studentët do të jenë të aftë:

1. Të tregojnë nivel të lartë të njohurive për metodat dhe teknikat e ndryshme në mësimdhënien e gjuhës italiane përmes *Përkthimit Pedagogjik* të arritura përmes diskutimeve aktive në leksione dhe seminare.
2. Të tregojnë nivel dhe kapacitet të lartë njohurish në diskutime dhe debate rreth çështjeve të parashtruara gjatë leksioneve në lidhje me gjuhën italiane si gjuhë e huaj dhe përkthimin pedagogjik.
3. Individualisht dhe në punë në grup të prezantojnë detyrat e kursit për tema të ndryshme (prezantime 8-10 minuta).